



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

Nr. 1613 / 10 Prot

Shkodër, me dt. 02.11.2023

NJOFTIM

**L ë n d a:** Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për për ngritje në detyrë në kategorinë drejtuese, pozicioni “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”.

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**KËSHILLIT TË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimit nr. nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Shkresës nr. 1613 prot, datë 10.10.2023, për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele, ngritje në detyrë dhe të pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin: **1 (një) pozicion – “Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve**, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2:

Konstatojmë se në përfundim të afatit (datë 31.10.2023), në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë drejtuese në pozicionin “*Shef Sektori, në Sektorin Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*” pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kategoria e ulët drejtuese III-2, janë paraqitur dy kandidatura të cilat i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta dhe të përgjithshme si më poshtë:

1. Florinda Gega
2. Laura Molla

Në këto rrethana bazuar në nenin 9 dhe 11 të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe kreut II, pika “5” të Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e

plotësimin të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” procedura *për ngritje në detyrë në shërbimin civil gjyqësor* do të vazhdoj me vleresimin profesional i cili **do të zhvillohet në përputhje me pikën 17 e vijuesë e këtij udhëzimi me datë 06.11.2023 në orën 13.30** në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KANCELARE**

**Valbona SULEJMANI**

